



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 12/2023 PËR KUSHTET DHE KRITERET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË AUTOMJETEVE ME QIRA

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 39 paragrafi 2, të Ligjit nr. 08/L-074 për Turizmin (Gazeta Zyrtare Nr. 15. 13.06.2022), Shtojcës 12 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15/ 12.09.2011).

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 11/2023 PËR KUSHTET DHE KRITERET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË AUTOMJETEVE ME QIRA

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve të automjeteve për udhëtar me qira (*rent-a-car*).

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ aplikohen për shoqëritë tregtare që ushtrojnë veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të automjeteve me qira (*rent-a-car*).

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij udhëzimi administrativ përkufizimet në vijim kanë këtë kuptim:

1.1. Automjet udhëtarësh - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetë (8) ulëse;

1.2. Automjet me qira (*rent-a-car*) – shërbim i ofrimit të automjetit për pasagjer me qira, duke përfshirë mjetet për kampim, pa shofer, me një kontratë qiraje, nga shoqëritë tregtare që ofrojnë këtë shërbim për persona fizik;

1.3. Mjet për kampim - automjet ose mjet i bashkëngjitur, i konstruktuar veçanërisht në atë mënyrë që në të ketë pajisje të përforcuara për mjeti, një pjesë e të cilave kur nuk nevojiten, palosen për të zënë më pak hapësirë, si: karriget me tavolinë, krevati (i cili mund të fitohet me tërheqje të karrigeve, elementet e kuzhinës dhe hapësirën për vendosje të rrobave, dhe të cilat mundësojnë përdorimin si mjet kampimi;

1.4. Sigurimi i auto përgjegjësisë - sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit dhe poseduesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta siç rregullohet me ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

2. Përkufizimet dhe shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrative kanë kuptimin e njëjtë siç përcaktohet në ligjin për turizmin apo aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 4

Kushtet për ofrimin e shërbimeve të automjeteve me qira

1. Shërbimet e ofrimit të automjeteve me qira mund të ofrohen nga shoqëria tregtare e regjistruar në pajtim me ligjin përkatës për shoqëritë tregtare, e cila plotëson kushtet si në vijim:

1.1. Ka të regjistruar si veprimtari, ofrimin e shërbimit të automjeteve me qira;

1.2. Gjatë gjithë kohës të ketë të regjistruara dhe të siguruara të gjitha automjetet sipas legjislacionit përkatës për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia;

1.3 Të kenë së paku 10 (dhjetë) automjete të përshtatshme për vozitje për qiramarrësit;

1.4. Automjetet nuk duhet të kenë më shumë se 200.000 km (dy qind mijë kilometra) të bëra.

1.5. Të ketë të paktën një lokal afarist në të cilin ushtron veprimtarinë;

1.6. Të sigurojnë që automjetet e marra me qira të jenë të përshtatshme për rrugë dhe të plotësojnë kërkesat teknike;

1.7. Të siguroj mirëmbajtjen e automjeteve në gjendje të sigurt dhe funksionale;

1.8. Të mbajnë shënime për historinë e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve;

1.9. Të kenë siguruar vende të mjaftueshme parkimi për dorëzimin e automjeteve;

1.10. Të lidh kontratë qiraje për shfrytëzim të automjetit me udhëtarin që përmban elementet e përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi administrativ;

1.11. Të informoj udhëtarin për kushtet e përgjithshme për qira të automjetit, duke përfshirë gjendjen teknike të automjetit, certifikatën e regjistrimit të automjetit, certifikatën e sigurimit nga auto përgjegjësia, rezultatet e kontrollës së fundit teknike, çdo kufizim të mundshëm në përdorim, dhe i ofron informacionet në dispozicion të udhëtarit në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe për shtetasit e huaj, të paktën edhe në gjuhën angleze;

1.12. Të mbaj një libër shënimesh, në të cilin do të regjistrohet çdo kontratë e dhënies me qira të automjetit, koha e dorëzimit dhe kthimit të tij;

1.13. Të sigurojë që qiramarrësi ka të drejtë të drejtoj automjetin dhe është i pajisur me patentë-shofer origjinal në Republikën e Kosovës;

1.14. Të siguroj që shtetasi i huaj ka të drejtë të shfrytëzoj makinën me qira dhe të ketë patentë-shofer origjinal të vlefshme vendore ose të një vendi të huaj.

1.15. Të ketë një politikë të brendshme të ruajtjes së të dhënave personale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

1.16. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushat e përcaktuara me këtë udhëzim duhet të regjistrohen në regjistrin e turizmit duke përfshirë edhe regjistrimin e shërbimeve që ushtrojnë, në përputhje me rregullat e përcaktuara me udhëzimin administrativ për regjistrin e turizmit, sipas shtojcës nr.1 Formulari për regjistrim te agjencisë se udhëtimit në regjistrin e turizmit, ku pika 2 e formularit përjashtohet për operatorët ekonomike të cilët duhet të plotësojnë kriteret të përcaktuara në këtë nen.

Neni 5

Kontrata për qiranë e automjetit

1. Ofruesit e shërbimit të automjeteve me qira duhet të lidhin kontratë në secilin rast të ofrimit të automjeteve me qira, e cila duhet të përcaktoj ndër të tjera:

1.1. Emrin dhe informacionin e kontaktit të shoqërisë tregtare që ofron automjetin me qira dhe të qiramarrësit;

1.2. Kushtet specifike të marrëveshjes së qirasë, duke përfshirë periudhën e qirasë, datat e marrjes dhe kthimit, dhe vendin e marrjes dhe kthimit të automjetit;

1.3. Tarifën e qirasë dhe çdo tarifë shtesë nëse janë të aplikueshme (p.sh., taksat, sigurimet kasko etj.) dhe mënyrën e pagesës së tyre;

1.4. Informacion në lidhje me mbulimin e sigurimit të përfshirë, duke përfshirë rastet e sigurimit nga aksidenti, vjedhjet dhe sigurimi i përgjegjësisë, dhe të përfshijë çdo shumë për të cilën qiramarrësi mund të jetë përgjegjës në rast dëmtimi ose humbjes së automjetit, nëse ato janë të aplikueshme;

1.5. Të shpjegojë kushtet e veçanta që kanë të bëjnë me karburantin, duke përfshirë nëse automjeti është i pajisur me një rezervuar të plotë dhe duhet të kthehet me një rezervuar të plotë ose nëse ka marrëveshje alternative (p.sh., opsioni i karburantit me parapagim);

1.6. Të përshkruajë automjetin e marrë me qira, duke përfshirë markën, modelin, numrin e targës dhe çdo veçori apo pajisje dalluese, si dhe gjendjen fizike të automjetit në momentin e pranim – dorëzimit;

1.7. Të përshkruajë çdo kufizim ose kusht për përdorimin e automjetit, të tilla si kufizimet e kilometrazhit, aktivitetet e ndaluara (p.sh., ngasja jashtë rrugës) dhe penalltitë e mundshme për mospërputhje lidhur me këto rregulla;

1.8. Nëse janë të aplikueshme kufizimet për përdorim të automjetit jashtë territorit të Republikës së Kosovës, dhe çdo sigurim shtesë të aplikueshëm, duke specifikuar po ashtu nëse qiramarrësi duhet të paguaj kosto shtesë;

1.9 Shumën e depozitës së garancisë, mënyrën se si do të mbahet dhe kushtet për lirimin e saj pas kthimit të automjetit;

1.10. Dispozita me të cilat përcaktohet se automjeti duhet të kthehet në gjendjen që është marrë dhe se qiramarrësi nuk ka të drejtë të bëjë asnjë intervenim në automjet pa njoftimin paraprak të qiradhënësit. Në të njëjtën kohë, aty duhet të përfshihen edhe veprimet që duhet të ndërmerret qiramarrësi në rast të aksidenteve dhe dëmtimit të veturës me ose pa fajin e tij.

1.11.Kushtet, procedurat dhe çdo tarifë apo penallti të mundshme që lidhet me anulimin ose modifikimin e rezervimit të automjetit me qira;

1.12 .Çdo mosmarrëveshjeve midis operatorit ekonomik dhe qiramarrësit duhet të zgjidhet sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

2. Një kopje e kontratës së qirasë duhet ti sigurohet udhëtarit.

3. Për çështjet tjera rreth kontratës së qirasë, të cilat nuk janë përfshirë në këtë udhëzim administrativ aplikohen dispozitat e ligjit përkatës për marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 6

Obligimi për tu regjistruar në regjistrin e turizmit

1.Çdo shoqëri tregtare që ushtron veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të automjeteve me qira, regjistrohet në regjistrin e turizmit sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ për Regjistrin e turizmit brenda 30 ditësh nga dita e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.

2. Kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni, fillojnë të aplikohen nga momenti i funksionalizimit të Regjistrin të Turizmit.

Neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrja dhe inspektimi duhet të kryhet nga inspektorati kompetent i tregut për operatorët ekonomin të cilët japin kerre me qira.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 16.11.2023

Rozeta HAJDARI

Ministre